

UDHËZIMET PËR COVID-19

COVID-19 është test për shoqëritë, për qeveritë, për komunitetet dhe për individët. Është koha për solidaritet dhe bashkëpunim për ta ndaluar virusin dhe për të zvogëluar efektet, shpesh të paparashikuara, të masave të caktuara për të ndaluar përhapjen e COVID-19. Respektimi i të drejtave të njeriut në mbarë spektrin, duke përfshirë të drejtat ekonomike dhe sociale, të drejtat civile dhe politike, do të jetë fundamental në suksesin e reagimit për shëndetin publik.

QASJA NË KUJDESIN SHËNDETËSOR

- Strategjitë shëndetësore duhet të trajtojnë jo vetëm dimensionet mjekësore të pandemisë, por edhe të drejtat e njeriut dhe pasojat specifike gjinore të masave të ndërmarra si pjesë e reagimit shëndetësor.
- Trajtimi duhet të jetë në dispozicion për të gjithë pa diskriminim, duke përfshirë ata më të rrezikuar dhe të marginalizuar. Kjo nënkupton sigurimin që askujt të mos i mohohet trajtimi me kohë dhe adekuat për shkak se nuk i kanë mjetet për të paguar për këtë, duke u bazuar në moshën, ose për shkak se stigma i parandalon ata nga marrja e trajtimit.

MASAT EMERGJENTE

- Qeveritë duhet të marrin vendime të vështira për t'ju përgjigjur COVID-19. E drejta ndërkombëtare lejon masa emergjente si reagim ndaj kërcënimeve të mëdha, por masat që kufizojnë të drejtat e njeriut duhet të jenë në proporcion me rrezikun e vlerësuar, të jenë të nevojshme dhe të zbatueshme në mënyrë jodiskriminuese. Kjo do të thotë se ato duhet të kenë një fokus dhe kohëzgjatje specifike, duke përdorur qasjen sa më pak të bezdisshme të mundshme për mbrojtjen e shëndetit publik.
- Kur shpallen gjendjet emergjente, shtetet që janë palë të Konventës ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike duhet t'i përmbushin detyrimet e tyre ligjore për të bërë njoftime formale përmes Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së. Traktatet rajonale për të drejtat e njeriut përfshijnë obligime të ngjashme.
- Sa i përket COVID-19, kompetencat për situata emergjente duhet të përdoren vetëm për objektiva legjitime të shëndetit publik, dhe jo të përdoren si bazë për shpërfilljen e mospajtimeve dhe heshtjen e punës së mbrojtësve të të drejtave të njeriut apo të gazetarëve, apo të ndërmarrin hapa të tjerë që nuk janë strikt të nevojshëm në trajtimin e gjendjes shëndetësore. Disa të drejta nuk mund të kufizohen madje as gjatë një gjendje emergjente (të drejta të pacenueshme), duke përfshirë edhe parimin e mosdëbimit, ndalimin e largimit kolektiv, ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit, të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjen dhe religjionin dhe të tjera.
- Qeveritë duhet të informojnë popullatën e prekur se cilat janë masat emergjente, ku zbatohen ato dhe sa kohë synojnë të mbesin në fuqi, dhe këtë informacion duhet ta përditësojnë rregullisht dhe ai të jetë në dispozicion për të gjithë.
- Sa më shpejt që të jetë e mundshme, për qeveritë do të jetë e rëndësishme të sigurojnë kthimin e jetës në

normalitet, dhe jo të përdorin pushtetin emergjent që pafundësisht të rregullojnë jetën e përditshme, duke pranuar se reagimi duhet të përshtatet me nevojat e fazave të ndryshme të kësaj krize.

PËRFSHIRJA E TË GJITHËVE

- Të gjitha shoqëritë kanë individë të cilët janë të marginalizuar dhe përballen me vështirësi lidhur me qasjen në informacione dhe shërbime publike për disa arsye, ku disa prej përballen me diskriminim të thellë ose përçarje politike. Në dhënien e informacioneve për COVID-19 dhe përpjekjeve për reagim duhet pasur kujdes të veçantë në identifikimin e njerëzve të cilët mund të jenë në rrezik të anashkalohen ose të përjashtohen, siç janë pakicat nacionale, etnike apo religjioze, populli vendës, emigrantët, personat e zhvendosur dhe refugjatët, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, individët LGBTI ose ata të prekur nga varfëria ekstreme.
- Institucionet nacionale për të drejtat e njeriut, shoqëria civile dhe komunitetet lokale mund të ndihmojnë në identifikimin e njerëzve të cilët ka gjasa të anashkalohen apo të përjashtohen, duke mbështetur bartjen e informacioneve tek këto grupe, dhe duke u siguruar informacione autoriteteve mbi ndikimin e masave tek komunitetet.

STREHIMI

- Derisa njerëzve u bëhet thirrje të qëndrojnë në shtëpi, është thelbësore që qeveritë të ndërmarrin masa urgjente të ndihmojnë njerëzit pa strehim adekuat, meqë të qëndruarit në shtëpi dhe mbajtja e distancës sociale është jashtëzakonisht e vështirë për njerëzit që jetojnë në kushte të mbipopullimit, për të pastrehët dhe ata të cilët nuk kanë qasje në ujë dhe kushte higjienike. Praktikrat e mira për mbrojtjen e njerëzve që jetojnë në objekte banimi joadekuate dhe i të pastrehëve, përfshijnë sigurimin e strehimeve emergjente (duke përfshirë shfrytëzimin e njësisve banesore të zbrazëta dhe të braktisura, pronave me qira të disponueshme për një afat të shkurtër) me shërbime për ata të cilët janë të prekur nga virusi dhe duhet të izolohen.
- Autoritetet duhet të ndërmarrin hapa të planifikuar për të parandaluar mbetjen pa strehë të njerëzve të tjerë, p.sh. kur njerëzit përballen me dëbimin kur humbja e të ardhurave e bën të pamundur pagesën e hipotekave ose qirave. Praktikrat e mira siç janë ndalimi i dëbimeve dhe shtyrja e pagesave të hipotekave duhet të zbatohen gjerësisht.
- Kur dhe ku imponohen masat e kufizimit, askush nuk duhet dënuar për shkak se janë të pastrehë ose jetojnë në objekte banimi joadekuate.

NJERËZIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- Personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik shumë më të lartë nga COVID-19, dhe reagimi i shtetit duhet të përfshijë masa të planifikuara për t'i trajtuar ata. Masat për reagim ndaj krizës dhe intervenimet shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale, duhet të jenë të qasshme për të gjithë dhe të mos diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.
- Distancimi fizik, vetizolimi dhe masat tjera emergjente duhet të marrin parasysh nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara të cilët mbështeten në rrjetet e përkrahjes esenciale për mbijetesën e tyre, disa prej të cilëve mund të përballen me tensione të theksuara për shkak të izolimit.
- Shtetet duhet të vendosin masa shtesë për të garantuar vazhdimësinë e rrjeteve mbështetëse për njerëzit me aftësi të kufizuara gjatë kësaj krize. Kur kufizimet e lëvizjes pengojnë rrjetet ekzistuese mbështetëse të familjes dhe shoqërisë, ata duhet zëvendësuar me shërbime të tjera.

- Duhet siguruar që vendimet për ndarjen e resurseve të pamjaftueshme (p.sh. ventilatorët) të mos bazohen në dëmtimet paraegzistuese, nevoja për mbështetje më të madhe, cilësia e vlerësimeve të jetës ose anësia mjekësore kundër njerëzve me aftësi të kufizuara.
- Shtetet duhet të sigurojnë që njerëzit me aftësi të kufizuara të mos mbesin pa përkrahje në institucione, në shtëpi të pleqve, në qendra psikiatrike dhe të tjera që janë bërë pika të nxehta të pandemisë, dhe të ndër marrin masa për të siguruar mbrojtjen e atyre që ndodhen në objektet e tilla.
- Qasja në ndihmë financiare shitesë dhe në mbrojtje sociale është thelbësore për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për familjet, meqë shumica prej tyre varen nga shërbimet që janë pezulluar, dhe mund t'ju mungojnë mjetet për të mbuluar nevojat e tyre elementare.

PERSONAT E MOSHUAR

- Personat e moshuar kanë të njëjtat të drejta sikurse çdo grupmoshë tjetër, dhe ata duhet të mbrohen në mënyrë të barabartë gjatë pandemisë. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar rreziqeve të caktuara me të cilat përballen njerëzit e moshuar, duke përfshirë izolimin dhe shpërfilljen si pasojë e distancimit fizik dhe diskriminimin në bazë të moshës në qasjen e trajtimit mjekësor dhe ndihmës tjetër. Protokoli i përzgjedhjes me përparësi duhet të bazohet në dëshmi shkencore dhe nevojës mjekësore.

NJERËZIT NË PARABURGIM DHE NË INSTITUCIONE

- Njerëzit e privuar nga liria, duke përfshirë edhe ata në burgje, në qendra paraburgimi, qendra ndalimi të emigrantëve, në institucione, në qendrat e detyrueshme për rehabilitim nga droga dhe në qendra të tjera ndalimi, kanë rrezik më të lartë nga infektimi në rast të një shpërthimi. Ekziston rrezik i lartë nga infektimi dhe distancimi fizik është vështirë i arritshëm. Gjendja e tyre në veçanti duhet trajtuar në planifikimin dhe reagimin ndaj krizave.
- Shtetet duhet të miratojnë masa speciale për të siguruar qasje në informacione dhe barazi në masat parandaluese dhe në kujdesin tjetër shëndetësor për të gjithë personat e privuar nga liria.
- Shtetet urgjentisht duhet të kërkojnë mundësi për lirim dhe alternativa për ndalimin për të ulur rrezikun e dëmit në vendet e ndalimit, përfshirë edhe për personat që kanë kryer kundërvajtje të lehta, të vogla dhe jo të dhunshme, ata me datë të afërt të lirimit, njerëzit me gjendje të dukshme shëndetësore, ata që janë në paraburgim apo në ndalim administrativ. Njerëzit e ndaluar pa bazë ligjore duhet të lirohen, sikurse edhe njerëzit në qendrat e detyrueshme të ndalimit për drogë ose në programe trajtimi.
- Duhet të ketë moratorium për fëmijët që hyjnë në paraburgim, dhe shtetet duhet t'i lirojnë të gjithë fëmijët nga ndalimi që mund të lirohen në mënyrë të sigurt.
- Gjendja e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe e personave të moshuar të cilët jetojnë në institucione është veçanërisht e rëndë. Kufizimi i kontakteve me familjet mund të arsyetohet si pjesë e masave emergjente shëndetësore, por mund të rezultojë që njerëzit me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar të shpërfillen dhe të abuzohen më shumë.

INFORMIMI DHE PJESËMARRJA

- Informacionet relevante për pandeminë COVID – 19 duhet të arrijnë tek të gjithë njerëzit, pa përjashtim. Kjo kërkon që informacionet të jenë të disponueshme në formate dhe gjuhë lehtësisht të kuptueshme, duke përfshirë edhe gjuhët vendëse dhe ato të pakicave nacionale, etnike dhe religjioze, dhe

informacionet të përshtaten për njerëzit me nevoja të veçanta, duke përfshirë ato me dëmtime të shikimit dhe dëgjimit, dhe të arrijnë tek ata të cilët kanë pak apo aspak aftësi për të lexuar apo që nuk kanë qasje në internet.

- Qasja në internet është esenciale për të siguruar që informacioni arrin tek ata që janë të ndikuar nga virusi. Qeveritë duhet t'i japin fund çfarëdo ndërprerjeje të internetit dhe ai duhet të jetë gjithmonë i lëshuar. Shtetet gjithashtu duhet të punojnë për të siguruar qasje sa më të gjerë të mundshme në shërbimet e internetit, duke ndërmarrë hapa për lidhjen e ndarjeve digjitale, duke përfshirë edhe zbrazëtirën gjinore.
- Njerëzit kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje që ndikon në jetën e tyre. Të qenit të hapur dhe transparent, dhe përfshirja e atyre që ndikohen nga vendimmarrja është kyçe për të siguruar që njerëzit të marrin pjesë në masat e përcaktuara për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe të popullatës së gjerë.
- Profesionistët e mjekësisë dhe ekspertët relevantë, duhet të jenë në gjendje të flasin lirshëm dhe të ndajnë informacione me njëri tjetrin dhe me publikun. Gazetarët dhe mediat duhet të jenë në gjendje të raportojnë për pandeminë, duke përfshirë reportazhe që kritikojnë reagimet e qeverisë, pa frikë dhe censurim. Duhet bërë përpjekje të bashkërenduara në nivel ndërkombëtar dhe në nivel nacional, për të kundërshtuar informacionet e rrejshme dhe ato çorientuese që nxisin frikë dhe paragjykimë.
- Përfshirja e perspektivave, e zërit dhe e dijes së grave në përgatitjen dhe reagimin ndaj shpërthimit është esenciale, duke përfshirë edhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre dhe rolin e tyre udhëheqës në hapësirat globale, regjionale dhe nacionale me COVID-19.

STIGMATIZIMI, KSENOFOBIA, RACIZMI

- Pandemia e COVID19 është duke shkaktuar një valë të stigmatizimit, diskriminimit, racizmit dhe ksenofobisë kundër grupeve të caktuara nacionale dhe etnike. Ne duhet të punojmë së bashku të luftojmë kundër kësaj tendence, duke përfshirë referimin e kësaj sëmundjeje si COVID-19 në vend të përdorimit të referencave gjeografike.
- Liderët politikë dhe figurat tjera me ndikim duhet të flasin fuqishëm kundër stigmatizimit dhe racizmit që e ka shkaktuar kjo krizë, dhe me çdo kusht duhet të shmangin përkeqësimin e diskriminimit të tillë. Shtetet duhet të veprojnë shpejt për të kundërshtuar retorikën që ushqen frikën, dhe të sigurojnë që reagimet e tyre ndaj COVID-19 të mos e bëjnë një popullatë të caktuar më të rrezikuar ndaj dhunës dhe diskriminimit.
- Shpërndarja e informacioneve të sakta, të qarta dhe të bazuara në dëshmi dhe fushatat për ngritjen e vetëdijesimit janë mjetet më efikase kundër diskriminimit dhe ksenofobisë, të cilat e ushqejnë keqinformimin dhe frikën. Për të monitoruar incidentet e diskriminimit dhe ksenofobisë nevojiten përpjekje shtesë, dhe reagimet ndaj incidenteve duhet të jenë të shpejta dhe të mirëkomunikuara.

EMIGRANTËT, PERSONAT E ZHVENDOSUR DHE REFUGJATËT

- Emigrantët, personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) dhe refugjatët përballen me rreziqe specifike, meqë ata mund të jenë të izoluar në kampe dhe vendbanime, ose jetojnë në lagje urbane të mbipopulluara, me sanitari të dobët dhe shërbime shëndetësore joadekuate ose të paqasshme.
- Emigrantët dhe refugjatët shpesh përballen me pengesa në qasjen e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë edhe barrierat gjuhësore dhe kulturore, shpenzimet, mungesën e qasjes në informacione, diskriminimin dhe ksenofobinë. Në një gjendje jo të rregullt emigrantët mund të mos jenë në gjendje apo të mos e kenë dëshirën t'i qasen kujdesit shëndetësor, apo të japin informacione mbi gjendjen e tyre shëndetësore nga frika apo rreziku i ndalimit, deportimit apo penalizimit si pasojë e statusit të tyre të emigrantit.

- Shtetet duhet të ndërmarrin veprime specifike për të përfshirë emigrantët, PZHBV-të dhe refugjatët në parandalimin dhe reagimin nacional ndaj COVID-19. Kjo duhet të përfshijë sigurimin e qasjes së barabartë në informacione, testim dhe kujdes shëndetësor për të gjithë emigrantët, PZHBV-të dhe refugjatët, pavarësisht statusit të tyre, si dhe ekzistimit të mureve për mbrojtje nga zjarri që i veçojnë emigrantët dhe refugjatët nga mundësia e qasjes në shëndetësi, në shpërndarje të ushqimit dhe në shërbime të tjera esenciale.
- Urgjentisht nevojitet përkrahje ndërkombëtare për të ndihmuar shtetet nikoqire të avancojnë shërbimet për emigrantët, për PZHBV-të, për refugjatët dhe për komunitetet lokale, dhe ata të përfshihen në masat nacionale për parandalim dhe reagim. Mosrealizimi i kësaj do të rrezikojë shëndetin e të gjithëve, dhe rrezikon të rrisë armiqtë dhe stigmatizimin. Po ashtu duhet ndërmarrë hapa specifik për të kundërshtuar armiqtë dhe ksenofobinë drejtuar emigrantëve, PZHBV-ve ose refugjatëve.
- Është po ashtu thelbësore që çfarëdo kontrollesh të përforcuara të kufirit, ndalimet e udhëtimit apo kufizimet e lirisë së lëvizjes, të mos parandalojnë njerëzit të cilët mund të jenë duke u larguar nga lufta apo ndjekja nga qasja në siguri dhe mbrojtje, të cilët përndryshe kanë të drejtë në mbrojtje sipas ligjit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

NDIKIMET SOCIALE DHE EKONOMIKE

- E drejta për arsim duhet të mbrohet në rast të mbylljes së shkollave p.sh., dhe kur është e mundur mund të jenë të prekura në mënyrë disproporcionale meqë shumica prej tyre tanimë përballen me pengesa të mëdha për të vijuar shkollimin, dhe tani nga ato mund të pritet të ngarkohen me punë të shtuara të kujdesit në shtëpi. Mundësitë e kufizuara arsimore për ata pa qasje në internet rrezikon thellimin e pabarazive dhe varfërisë. Vajzat dhe djemtë mund të humbasin qasjen në ushqim të shëndetshëm dhe në shërbimet tjera që shkollat shpesh i ofrojnë.
- Skemat për mbrojtjen sociale duhet t'u kushtojnë vëmendje të posaçme fëmijëve për shkak të rrezikshmërisë së lartë me të cilën ata përballen bazuar në fazën e tyre të hershme të zhvillimit fizik, intelektual dhe emocional. Praktikant më të mira përfshijnë transfere parash familjeve me fëmijë, që kanë qenë efektive në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Duhet të ndahen praktikant e mira nga qeveritë, sektori publik dhe privat, organizatat ndërkombëtare dhe nacionale, për të lehtësuar efektet negative socio-ekonomike të kësaj krize.
- Shëndeti dhe siguria profesionale a atyre që punojnë gjatë kësaj krize, në veçanti punëtorët shëndetësorë, duhet të vlerësohen dhe të trajtohen. Punëtorëve shëndetësorë dhe të tjerëve që punojnë në ambiente të rrezikshme duhet t'u sigurohen pajisje personale mbrojtëse cilësore sipas nevojës. Askush nuk duhet të ndihet i detyruar të punojë në kushte që në mënyrë të panevojshme e rrezikojnë shëndetin e tyre nga frika e humbjes së punës apo pagës.
- Stimulimi fiskal dhe paketat për mbrojtje sociale të synuara drejtpërsëdrejti atyre që më së paku janë në gjendje të përballen me krizën, janë esenciale në zbutjen e pasojave shkatërruese të pandemisë. Masat e menjëhershme për ndihmë ekonomike siç janë pushimi i garantuar mjekësor me pagesë, vazhdimi i përfitimeve nga papunësia, shpërndarja e ushqimit, kujdesi për fëmijët dhe të ardhurat universale bazike mund të ndihmojnë në mbrojtjen kundër efekteve akute të krizës.

USHQIMI

- Kriza e COVID-19 e keqëson pasigurinë ushqimore, meqë kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe pamjaftueshmëria e veshjeve mbrojtëse ndikon te punëtorët bujqësor, shumica prej të cilëve janë emigrantë në disa rrethana. Urgjentisht duhet të merren masa për të siguruar lëvizjen dhe kushtet e sigurta të punës për punëtorët bujqësorë për sigurimin e prodhimit të ushqimit, sikurse edhe trajtimet e posaçme siç janë mbështetja financiare dhe qasja në kredi për fermerët e vegjël, posaçërisht gratë.

- Nevojitet ndërmarrja e hapave urgjente për trajtimin e pasigurisë ushqimore për segmentet më të varfëra dhe më të marginalizuara të popullatës. Duhet ndërmarrë masa që synojnë sigurimin e menjëhershëm të përkrahjes për plotësimin e nevojave ushqimore të popullatës, përfshirë edhe përmes sigurimit të asistencës për artikuj ushqimorë dhe ushqyerje.

PRIVATËSIA

- Monitorimi i shëndetit përfshin një sërë mjetesh që gjurmojnë dhe monitorojnë sjelljen dhe lëvizjet e individëve. Vëzhgimi dhe monitorimi i tillë duhet veçanërisht të lidhet me qëllimet specifike të shëndetit publik dhe të shfrytëzohet për ato, dhe duhet të kufizohen në kohëzgjatje dhe fushëveprim sipas kërkesës në situatën e caktuar. Duhet zbatuar masa mbrojtëse të ashpra për të siguruar që masat e tilla nuk keqpërdoren nga qeveritë apo kompanitë në grumbullimin e informacioneve private konfidenciale për qëllime që nuk ndërlidhen me krizën e shëndetit publik.

FËMIJËT

- Derisa fëmijët duket se kanë më pak simptoma dhe shkallë më të ulët të mortalitetit nga COVID-19, janë shfaqur rreziqe të konsiderueshme në mbrojtjen e fëmijëve në baza ditore si pasojë e masave të ndërmarrja për parandalim dhe frenim të virusit. Shtetet duhet t'u kushtojnë vëmendje të shtuar nevojave për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve kur ata i përgatisin reagimet e tyre ndaj pandemisë dhe planet e rimëkëmbjes. Interesat më të mira të fëmijëve duhet të kenë vëmendjen primare dhe qendrore në këtë reagim.
- E drejta në arsim është ndërprerë për më shumë se 1.5 miliardë fëmijë në mbarë botën, meqë 188 shtete kanë imponuar mbylljen e shkollave në mbarë vendin.
- Urdhërat për të qëndruar në shtëpi dhe izolimi po ashtu janë duke e dëmtuar shëndetin fizik dhe mental të fëmijëve. Mbyllja në shtëpi mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj rrezikut të shtuar të dhunës, duke përfshirë keqtrajtimin dhe dhunën seksuale. Ndihma dhe strehimoret për fëmijët në rrezik duhet të vazhdojnë si çështje me prioritet.
- Me miliona fëmijë përballen me varfëri meqë pjesëtarët e familjes së muren apo nuk janë në gjendje të punojnë. Posaçërisht në rrezik janë fëmijët në situata të rrezikuara, përfshirë edhe fëmijët që jetojnë në rrugë, fëmijët e emigrantëve dhe refugjatëve, fëmijët viktimë të trafikimit apo kontrabandimit, fëmijët që jetojnë në zona të konfliktit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

ÇËSHTJA GJINORE

- Gratë dhe vajzat ka gjasa të përballen me rritjen e rolit të tyre në ofrimin e kujdesit në shtëpi, duke u shkakuar atyre tensione shtesë dhe potencialisht duke e rritur rrezikun e infektimit. Në mbarë globin, gratë përbëjnë 70% të punëtorëve shëndetësor, duke përfshirë mamitë, motrat medicinale, farmacistët dhe punëtorët shëndetësorë në komunitet në linjën e parë, duke rritur rrezikun e tyre të ekspozimit dhe infektimit. Nevojiten masa të planifikuara për të trajtuar ndikimin disproporcional të krizës mbi gratë dhe vajzat.
- Në shumë shtete gratë përballen me rreziqe disproporcionale në sektorin e punës, ku shumica punojnë në sektorin joformal (p.sh. shërbëtores, kujdestare fëmijësh, punë bujqësore apo ndihmëse të biznesit familjar) dhe mund të jenë të parat që e humbin punën apo që preken nga pasojat e krizës meqë ata nuk kanë sigurim social, sigurim shëndetësor apo pushim me pagesë. Shumica prej grave po ashtu varen nga qasja dhe

mundësia e ofrimit të kujdesit për fëmijë, që tani është në rënie, duke kufizuar edhe më shumë gjasat e tyre për të punuar dhe fituar të ardhura.

- Gratë e moshuara ka më shumë gjasa të jetojnë në varfëri apo me pensione të ulëta apo pa pensione, që mund të përkeqësojë ndikimin e virusit dhe të kufizojë qasjen e tyre në mallra, ushqime, ujë, informacione dhe shërbime shëndetësore.
- Masat kufizuese të shëndetit publik, përfshirë urdhrat për të qëndruar në shtëpi ose izolimet, rrisin ekspozimin ndaj dhunës në baza gjinore, veçanërisht dhuna ndaj partnerit intim dhe dhunës në familje. Përkrahja dhe strehimoret e sigurta për viktimat e dhunës në baza gjinore duhet të vazhdojnë si prioritet, duke përfshirë referimet efektive dhe sigurimin e rrugëve të disponueshme për sigurinë e viktimave. Informacionet mbi linjat e drejtpërdrejta dhe shërbimet në internet duhet të përfshihen në kumtesat për COVID-19.
- Shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues duhet parë si prioritet për shpëtimin e jetës dhe pjesë esenciale e reagimit, duke përfshirë qasjen në mjete kontraceptive, kujdesin ndaj nënës dhe të porsalindurit, trajtimin e STI, kujdesin e sigurt të abortimit dhe rrugët e sigurta të referimeve. Duhet bërë përpjekje që resurset të shfrytëzohen për shërbimet esenciale të shëndetit seksual dhe riprodhues, dhe jo të orientohen në drejtime të tjera, që në veçanti do të cenonte të drejtat dhe jetën e grave dhe vajzave.
- Individët LGBTI po ashtu përballen me rrezik të shtuar gjatë kësaj pandemie, dhe në planet reaguese duhet inkorporuar masa specifike për trajtimin e këtyre ndikimeve. Të dhënat që janë në dispozicion tregojnë se individët LGBTI ka më shumë gjasa të punojnë në sektorin joformal, dhe kanë shkallë më të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Shërbimet shëndetësore që në veçanti janë relevante për individët LGBTI duhet të vazhdojnë gjatë kësaj krize, përfshirë edhe trajtimin dhe testimin për HIV.
- Shtetet duhet të trajtojnë çështjen e keqinformimit që nxit edhe më shumë stigmatizimin dhe diskriminimin ndaj individëve LGBTI, duke përfshirë tregimet ku për pandeminë fajësojnë individët LGBTI.

UJI DHE INSTALIMET HIDROSANITARE

- Larja e duarve me sapun dhe ujë të pastër është linja e parë e mbrojtjes kundër COVID -19, por 2.2 miliardë njerëz nuk kanë qasje në shërbime të sigurta të ujit. Trajtimi i nevojave të popullatës së rrezikuar, përfshirë edhe ata me qasje joadekuate në ujë, është esenciale në sigurimin e suksesit në luftën globale kundër COVID-19.
- Masat e menjëhershme që mund të ndihmojnë përfshijnë ndaljen e ndërprerjeve të ujit atyre që nuk mund të paguajnë faturat e ujit, sigurimin e ujit, sapunit dhe dezinfektuesve falas (siç janë përmes bombolave mobile në komunitete pa qasje në sanitari adekuate) gjatë kësaj krize për njerëzit e varfër dhe ata të prekur nga vështirësitë ekonomike në ardhje.

POPULLI VENDËS

- Shtetet duhet të marrin parasysh 'konceptet e veçanta mbi shëndetin' të popujve vendës, përfshirë edhe mjekësinë e tyre tradicionale, të konsultohen dhe të marrin parasysh pëlqimin paraprak të lirë dhe të mirinformuar të popujve vendës në caktimin e masave parandaluese mbi COVID-19.
- Shtetet duhet të vendosin masa për kontrollimin e hyrjes së cilitdo personi në territoret vendëse, në konsultim dhe bashkërendim me popujt vendës në fjalë, veçanërisht përmes institucioneve të tyre përfaqësuese.

- Për ata popuj vendës që jetojnë në izolim vullnetar ose kanë pas kontakt fillestar, shtetet dhe palët tjera ata duhet t'i konsiderojnë grupe me rrezik të veçantë. Duhet të vendosen kordone strikte që parandalojnë hyrjen e të huajve në territorin e këtyre popujve për të evituar çdo kontakt.

PAKICAT

- Shtetet duhet të vendosin masa shtesë për të trajtuar ndikimet disproporcionale që pakicat mund t'i kenë nga kriza shëndetësore me COVID-19, për shkak të viseve apo rajoneve të largëta ku ata jetojnë, shpesh me qasje të kufizuar në shërbimet dhe mallrat bazike. Pakicat shpesh jetojnë në kushte banimi të mbipopulluara, duke e bërë distancimin fizik dhe vetizolimim edhe më sfiduese. Qasja e kufizuar digjitale dhe zbrazësitë në edukimin prindëror mësimin në shtëpi mund ta bëjnë më të vështirë.
- Personat që u përkasin pakicave ka më shumë mundësi të përjashtohen nga kujdesi shëndetësor për shkak se ata nuk kanë mjete ose dokumentacion zyrtar, ose për shkak të stigmatizimit ose diskriminimit. Shtetet duhet të sigurojnë qasje në kujdesin shëndetësor për pakicat, duke përfshirë edhe ata pa sigurim shëndetësor ose pa dokumente identifikimi.

SANKSIONET NDËRKOMBËTARE DHE UNILATERALE

- Bashkësia ndërkombëtare duhet të avokojë heqjen, ose së paku pezullimin, e të gjitha sanksioneve që pengojnë mundësitë për të luftuar në mënyrë efektive pandeminë COVID-19, dhe i privojnë ata që kanë nevojë për shërbime mjekësore thelbësore.
- Nga qeveritë që aplikojnë sanksione kërkohet që menjëherë të rishikojnë dhe të tërheqin masat që mund të pengojnë përpjekjet e shteteve t'i përgjigjen pandemisë COVID-19, duke përfshirë edhe ata që parandalojnë blerjen apo transportimin e barërave, pajisjeve mjekësore apo mallrave të tjerë esencial, ndalojnë financimin për blerjen e barërave, pajisjeve mjekësore ose mallrave të tjerë esencialë, ose pengojnë dërgimin e ndihmës humanitare.